

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga Mitsotakis te Meloni dhe Merz, të dhënat personale të liderëve europianë në shitje online                                                                                                                                                       |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/rajoni/nga-mitsotakis-te-meloni-dhe-merz-te-dhenat-personale-te-lidereve-europa-i587994">https://www.gazetatema.net/rajoni/nga-mitsotakis-te-meloni-dhe-merz-te-dhenat-personale-te-lidereve-europa-i587994</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                                                                      |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 23 shtator 2026, 19:27:09 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 19:25:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | ddcd5f6c9a875a16edcd37f1142329c776dc7b455281ec05b7991d992a8dc7a1 |
| TEKSTI     | a42588e0516a3ff24298242d4d31c66fec232fba1ea49ae6a456050a5477aec0 |
| PAMJA      | 142b24718059a5b8ac7b2b192293246a5462054058f8fd84bf1f8515721a9924 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 6ab1ab34aff6470d4a191a81ed734d72922dab8d1963e06ec0ad5cdf7e00241c                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6ab1ab34aff6470d4a191a81ed734d72922dab8d1963e06ec0ad5cdf7e00241c>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie [Nga Mitsotakis te Meloni dhe Merz, te dhënat personale te liderëve europiane ne shitje online](#)Arrestimi i Shpetim Aliut ne Rusi, Policia ndan detajet e operacionit, do ekst fundit

## Nga Mitsotakis te Meloni dhe Merz, të dhënat personale të liderëve europianë në shitje online



23 Shtator 2026, 21:25Rajoni TEMA



Një hetim madhor i publikuar nga gazeta greke To Vima ka nxjerrë në dritë një skandal të madh të sigurisë kibernetike, duke zbuluar se numri I kontaktit dhe të dhëna të tjera personale të Kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis, si dhe të qindra zyrtarëve të tjerë të lartë, ishin lehtësisht të aksesueshme në platformat komerciale të shitblerjes së të dhënave të njohura si data-brokers.

Ky zbulim ka ngritur shqetësime të jashtëzakonshme për sigurinë kombëtare dhe privatësinë e krerëve të shteteve, pasi dëshmon se sa e thjeshtë është për këdo që të sigurojë informacione kaq të ndjeshme thjesht përmes platformave komerciale me pajtim.Përveç kryeministrit grek, ky problem i rëndë i sigurisë ka prekur edhe një rrjet të gjerë zyrtarësh brenda Greqisë, duke përfshirë ministra të qeverisë, drejtues të lartë biznesesh, personel ushtarak dhe zyrtarë të lartë të strukturave të sigurisë.

Përmasat e këtij skandali kalojnë kufijtë e Greqisë, pasi hetimi zbuloi se në të njëjtat platforma tregtare ishin të disponueshme edhe të dhënat private të kontaktit të liderëve të tjerë të rëndësishëm evropianë, mes të cilëve Kryeministria italiane Giorgia Meloni, Kancelari gjerman Friedrich Merz dhe Presidenti qipriot Nikos Christodoulides.Sipas sqarimeve të dhëna nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike të Greqisë, ky rast nuk ka të bëjë me ndonjë sulm kibernetik të drejtpërdrejtë apo hakerim të sofistikuar ndaj sistemeve të fshehta qeveritare. Kreu i këtij autoriteti, Michalis Bletsas, shpjegoi se këto informacione janë mbledhur nga gjurmët dixhitale që lihen çdo ditë në rrjet. Kjo përfshin të dhëna që vetë zyrtarët ose bashkëpunëtorët e tyre kanë ndarë ndër vite në rrjetet sociale, si dhe informacione që kanë rrjedhur më parë nga sulmet kibernetike ndaj bazave të të dhënave të kompanive të ndryshme private ku këta individë mund të kenë qenë të regjistruar, si hotele apo linja ajrore. Platformat data-broker thjesht i grumbullojnë këto të dhëna të shpërndara dhe i shesin si paketë të blerësit e interesuar.Ekspertët e sigurisë paralajmërojnë se disponueshmëria e këtyre numrave dhe kontakteve private krijon rreziqe serioze për sigurinë e këtyre liderëve, pasi lehtëson fushatat e shënjestruara të mashtrimit të njohura si spear-phishing. Përmes tyre, sulmuesit mund t'u dërgojnë zyrtarëve mesazhe shumë bindëse për t'i mashtruar apo për të infektuar pajisjet e tyre me programe spiune si spyware, ose mund t'i përdorin këto të dhëna për t'u hequr si zyrtarë të lartë shtetërorë përpara personave të tjerë. Publikimi i këtij hetimi ka ndezur menjëherë debate të ashpra politike në Greqi, ku partia kryesore e opozitës, PASOK, i ka bërë thirrje zyrtare qeverisë dhe autoriteteve përkatëse që të deklarojnë nëse ishin në dijeni të kësaj rrjedhjeje dhe të tregojnë se çfarë masash urgjente po merren për të mbrojtur sigurinë e vendit.



Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Demo pret ministrin malazez: Në fokus bashkëpunimi mes dy vendeve dhe integrimi në BE](#)

19:45 Rajoni

[Familjet Thaçi, Veseli e Krasniqi kërkojnë përgjegjësi institucionale: Presim të takohemi pas vendimit të Kuvendit](#)

19:35 Rajoni / 4 komente

Dhjetëra varreza masive në Serbi/ Komisioni për të gjeturit: Të rritet presioni ndaj Beogradit

18:25 Rajoni

Ballkani mbyll dyert - Kroacia, në qendër të strategjisë

17:35 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.